



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 90, datë 31.05.2021**

**PËR  
MARRJEN E MASAVE NDAJ SHOQËRISË ADMINISTRUESE TË FONDEVE TË  
PENSIONIT “SIGAL LIFE UNIQA GROUP” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikës 2 dhe pikës 21, si dhe nenit 32, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 80, 81, 102 dhe 103 të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Bazuar në nenin 80, pika 2 dhe nenin 81, pika 1, germa b), të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e pensionit vullnetar”, urdhërohet shoqëria administruese e fondeve të pensionit “Sigal Life Uniqa Group” sh.a:**
  - a. Të depozitohet menjëherë në Autoritet dokumentacionin e duhur për marrjen e miratimit të delegimit të funksioneve të shërbimit të marketimit të fondit të pensionit;**
  - b. Të përdoret në çdo rast kontratën dhe prospektin e miratuar nga Autoriteti lidhur me nivelin e tarifës së administrimit të fondit të pensionit, sipas kërkesave të nenit 6, pika 1 dhe nenit 9, pika 2, të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e pensionit vullnetar”;**
  - c. Të publikohet në faqen e internetit të shoqërisë administruese prospektin e miratuar nga Autoriteti;**
  - d. Të hartohet procedurë për ruajtjen dhe regjistrimin e ankesave;**
  - e. Të ketë të detajuar në procedurën e saj operacionale afatet dhe mjetet e komunikimit për informimin e anëtarëve në lidhje me ndryshimin e depozitarit të aseteve të fondit;**
  - f. Të ndalojë menjëherë praktikën e derdhjeve në llogarinë e fondit nga punonjësit e degëve dhe të shoqërisë në emër të anëtarëve të fondit të pensionit;**

- g. Të depozitojë në Autoritet raportin e vlerësimit të performancës për shërbimet që i janë deleguar të tretëve nëpërmjet marrëveshjes së delegimit;
  - h. Të hartohet plani vjetor i auditit të brendshëm duke i'u referuar një matrice risku;
  - i. Të njoftojë anëtarët e fondit 3 muaj para lindjes së të drejtës për përdorimin e aseteve neto në llogarinë e tyre të pensionit, sipas nenit 4, pika 2 dhe 4, të Rregullores nr. 126, datë 07.12.2010 “Mbi mënyrat, kushtet dhe procedurat e pagesave të pensionit vullnetar”;
  - j. Të marrë çdo masë tjetër që lidhet me korrigjimin e shkeljeve të konstatuara gjatë inspektimit.
2. Bazuar në nenin 81, pika 3, të Ligjit nr. 10197 datë, 10.12.2009 “Për Fondet e pensionit vullnetar”, shoqëria të zbatojë urdhërin e mësipërm duke raportuar në Autoritet brenda datës 30 qershor 2021.
3. Ngarkohen Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve dhe Drejtoria e Zbatueshmërisë dhe Parandalimit të Pastrimit të Parave, për njoftimin dhe ndjekjen e këtij vendimi.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR**

**Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Ervin METE**